- ☐ zbatohen, vetëm nëse lëvizin në vendbanim

3 pika

469. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shoferi i automjetit, që do të parakalohet nga automjetet nën përcjellje, është i detyruar:

- ☐ të vazhdojë me lëvizjen me shpejtësi të pandryshueshme
- ☐ ta ndalojë automjetin
- ☐ ta zvogëlojë shpejtësinë dhe t'i kyçë të gjithë katër treguesit e drejtimit

3 pika

470. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Tabelat për vozitje provë të automjeteve, i lëshon:

- ☐ Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
- ☐ Agjencioni për Rrugë Shtetërore
- ☐ Ministria e Punëve të Brendshme

3 pika

471. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në automjetin motorik të shënuar me tabela për vozitje provë:

- ☐ nuk guxon të barten persona tjerë as ngarkesë
- ☐ mund të barten persona, aq sa ulëse posedon
- ☐ mund të bartet ngarkesë, që nuk është më e rëndë se 300 kg

3 pika

472. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Sanksioni kundërvajtës, ndalim drejtimi me automjet motorik, shoferit mund t'i shqiptohet në kohëzgjatje prej:

- ☐ tre deri më 24 muaj
- ☐ tre deri më 18 muaj
- ☐ tre deri më 12 muaj

3 pika

473. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shoferët pjesëmarrës në aksident komunikacioni, në të cilin është i shkaktuar dëm i vogël material, janë të detyruar:

- ☐ të mos i zhvendosin automjetet dhe ta lajmërojnë policinë
- ☐ ta lajmërojnë shërbimin kompetent për mirëmbajtjen e rrugëve
- ☐ menjëherë t'i mënjanojnë automjetet nga rruga, të mundësojnë qarkullimin e papenguar të komunikacionit dhe ta plotësojnë dhe nënshkruajnë Raportin evropian për aksidentin e komunikacionit

3 pika

474. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shoferi fillestar që posedon patentë shoferi të kategorisë "B", në autostradë nuk guxon të lëvizë me shpejtësi më të madhe se:

- ☐ 80 km/h
- ☐ 90 km/h
- ☐ 100 km/h

3 pika

475. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shoferi fillestar që posedon patentë shoferi të kategorisë "B", në rrugë të rezervuar për automjete motorike nuk guxon të lëvizë me shpejtësi më të madhe se:

- ☐ 80 km/h
- ☐ 70 km/h
- ☐ 60 km/h

3 pika

476. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Leje për manifestime sportive dhe të tjera në rrugë, jep:

- ☐ Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
- ☐ Ministria e Punëve të Brendshme
- ☐ Organi kompetent në vetëqeverisjen lokale

3 pika

477. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në automjetin motorik të udhëtarëve në ulësen e përparme nuk guxon të vozitet fëmijë, më i vogël se:

- ☐ 8 vjet
- ☐ 10 vjet
- ☐ 12 vjet

3 pika

478. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në biçikletë, biçikletë me motor, moped, tricikël e lehtë, katërcikël e lehtë dhe katërcikël, guxon të vozitet fëmijë nëse i ka të mbushur më së paku:

- ☐ 7 vjet moshë dhe nëse ka të instaluar ulëse të veçantë para shoferit
- ☐ 8 vjet moshë
- ☐ 10 vjet moshë

3 pika

479. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shtegu i biçikletave është i dedikuar për komunikacion:

- ☐ vetëm për biçikleta
- ☐ për biçikleta, biçikleta me motor dhe mopedë
- ☐ vetëm për biçikleta dhe këmbësorë

3 pika

480. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse dy apo më shumë shoferë të biçikletave apo biçikletave me motor lëvizin në grup, janë të obliguar:

- ☐ të lëvizin paralelisht njëri pran tjetrit
- ☐ të lëvizin njëri pas tjetrit
- ☐ të lëvizin njëri përkaj tjetrit me distancë ndërmjet tyre më së paku një metër

3 pika

481. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në rrugë me biçikletë mund të drejtojë personi që ka mbushur:

- ☐ 10 vite moshë
- ☐ 9 vite moshë
- ☐ 8 vite moshë

3 pika

482. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Me moped në rrugë nuk guxojni të lëvizni me shpejtësi më të madhe se:

- ☐ 60 km/h
- ☐ 50 km/h
- ☐ 45 km/h

3 pika

483. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Drejtëpërdrejt para udhëkryqit, shoferi nuk guxon të parakalojë automjet tjetër përveç:

- ☐ traktorit
- ☐ motokultivatorit
- ☐ biçikletës, biçikletës me motor dhe motoçikletës pa rimorkio anësore

3 pika

484. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kur shenjat e komunikacionit të vendosura në rrugë devijojnë nga dispozitat për rregullat në komunikacion, shoferët janë të obliguar:

- ☐ të sillen sipas rregullave në komunikacion
- ☐ të sillen sipas vlerësimit të vet pa obligim për respektimin e shenjave të komunikacionit
- ☐ të sillen në përputhje me shenjat e komunikacionit

3 pika

485. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kur polici i uniformuar jep shenja apo urdhra, që devijojnë nga dispozitat për rregullat në komunikacion apo nga shenjat e vendosura të komunikacionit, shoferët janë të obliguar:

- ☐ të veprojnë sipas rregullave në komunikacion
- ☐ të veprojnë sipas shenjave apo urdhrave të policit të uniformuar
- ☐ të veprojnë në përputhshmëri me shenjat e komunikacionit

3 pika

486. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shoferi në mënyrë më të sigurt dhe më efikase do ta ndalojë automjetin:

- ☐ me përdorimin e frenit punues
- ☐ me përdorimin e frenit ndihmës
- ☐ me ndihmën e frenimit motorik

2 pika

487. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Sinjalet ndriçuese për paralajmërimin e pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, shoferi i jep:

- ☐ vetëm natën
- ☐ vetëm ditën
- ☐ natën dhe ditën

2 pika

488. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në trotuar, nëse është i lejuar ndalimi dhe parkimi i automjetit, shoferi është i detyruar që të lë hapësirë të lirë për lëvizje të këmbësorëve në gjerësi:

- ☐ prej 2 metrash
- ☐ prej 1,6 metrash
- ☐ prej 1 metër

2 pika

489. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Përdorimi i dritave të automjetit në komunikacion në rrugë, është i detyrueshëm:

- ☐ vetëm natën
- ☐ ditën dhe natën
- ☐ natën dhe ditën vetëm kur automjeti lëviz jashtë vendbanimit

2 pika

490. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në komunikacionin në rrugë, ditën dhe natën, shoferi i automjetit detyrimisht duhet t'i ketë të ndezura, më së paku:

- ☐ dritat e mesme
- ☐ dritat e gjata
- ☐ dritat pozicionale

2 pika

491. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Cilat drita, shoferi i automjetit do t'i përdorë, kur natën lëviz në kolonë të automjeteve:

- ☐ dritat e gjata
- ☐ dritat për shënimin e automjetit
- ☐ dritat e mesme

2 pika

492. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në kushte me mjegull, shoferi i automjetit është i obliguar që t'i ketë të kyçura:

- ☐ dritat e gjata për ndriçimin e rrugës
- ☐ dritat e mesme dhe dritat për mjegull
- ☐ vetëm dritat pozicionale për shënimin e automjetit

2 pika

493. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Automjetet nuk guxojnë në pjesën e përparme të kenë pajisje ndriçuese ose pajisje ndriçuese-sinjalizuese që japin ndriçim me:

- ☐ dritë të bardhë
- ☐ dritë të kuqe
- ☐ dritë të verdhë

2 pika

494. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Ngjyra e dritës së treguesve të drejtimit (vezëlluesve) është me:

- ☐ ngjyrë të kuqe
- ☐ ngjyrë të verdhë
- ☐ ngjyrë të bardhë

2 pika

495. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Automjetet motorike kur marrin pjesë në komunikacion në rrugë jashtë vendbanimit, duhet t'i kenë pajisjet e parapara dimërore në periudhë prej:

- ☐ 22 Dhjetor deri 22 Mars
- ☐ 15 Nëntor deri 15 Mars
- ☐ 15 Tetor deri 30 Mars

2 pika

496. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Rimorkion që e tërheq biçikleta, biçikleta me motor dhe motoçikleta, nuk guxon të jetë më e gjerë se:

- ☐ gjerësia e automjetit që e tërheq
- ☐ 1,5 metra
- ☐ një metër

2 pika

497. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Personi që do të ndodhë apo do të has në aksident komunikacioni në të cilën ka persona të lënduar, ka për obligim:

- ☐ t'u japë ndihmë personave të lënduar
- ☐ vetëm ta lajmërojë patrullën më të afërt policore
- ☐ nuk ka kurrfarë obligimi, sepse nuk është pjesëmarrës në aksidentin e komunikacionit

2 pika

498. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shoferi të cilit i është dhënë patentë shoferi i kategorisë “B” ka të drejtë të drejtojë edhe me automjete motorike që bëjnë pjesë në:

- ☐ kategoritë nacionale „F”, „G” dhe „M”
- ☐ kategorinë „A”
- ☐ kategorinë „A1”

2 pika

499. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shfrytëzimi i barërave psikoaktive të shënuara me trekëndësh të kuq në ambalazh, para dhe gjatë kohës së drejtimit me automjetin në rrugë, te shoferi:

- ☐ e zmadhojnë koncentrimin dhe vëmendjen
- ☐ në masë të madhe e zvogëlojnë aftësinë për vozitje
- ☐ nuk kanë kurrfarë ndikimi gjatë vozitjes

2 pika

500. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Dritat stop në pjesën e prapme të automjetit motorik aktivizohen gjatë përdorimit të:

- ☐ frerit ndihmës të automjetit
- ☐ frerit punues të automjetit
- ☐ frerit të parkimit të automjetit

2 pika

501. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kolona e organizuar e këmbësorëve kur lëvizë natën, jashtë vendbanimit, duhet të jetë e shënuar:

- ☐ në anën e parme të majtë me një dritë të bardhë, ndërsa në anën e majtë të prapme menjë dritë të kuqe
- ☐ në anën e parme të majtë me një dritë të kuqe, ndërsa në anën e prapme të majtë me një dritë të bardhë
- ☐ vetëm në anën e parme me një dritë të verdhë

2 pika

502. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shoferi i automjetit kur lëvizë natën në rrugë, për paralajmërim të pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, sipas rregullit duhet të shfrytëzojë:

- ☐ shenja të zëshme
- ☐ shenja ndriçuese
- ☐ nuk guxon të përdorë kurrfarë shenjash

2 pika

503. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Ajri i pamjaftueshëm në pneumatikët, përveç asaj që e pengon drejtimin me automjetin, sjell edhe deri te:

- ☐ zmadhimi i rezistencës gjatë lëvizjes, me të cilën shtohet harxhimi i lëndës djegëse
- ☐ zvogëlimi i rezistencës gjatë lëvizjes, me të cilën zvogëlohet brejtja e gomave
- ☐ stabiliteti më i madh i automjetit dhe zvogëlimi i harxhimit të lëndës djegëse

2 pika

504. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nga aspekti i sigurisë, më të mira dhe më të sigurta janë pneumatikët:

- ☐ me gomë të brendshme
- ☐ pa gomë të brendshme (tubeles)
- ☐ me thumba për shkak të fërkimit më të mirë me sipërfaqen e rrugës

2 pika

505. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Mbrojtëset që vihen në disa pjesë të rrugës, në të cilat zhvillohen punë në rrugë, ditën dhe natën në rast të zvogëlimit të dukshmërisë, shënohen me:

- ☐ dritë me ngjyrë të kuqe të vazhdueshme
- ☐ drita vezulluese me ngjyrë të kaltër
- ☐ drita vezulluese me ngjyrë portokalli

2 pika

506. (kat. B)

Në autostradë shoferi nuk guxon të qarkullojë me shpejtësi më të madhe se:
(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

507. (kat. B)

Në rrugë të rezervuar për komunikacion të automjeteve motorike, shoferi nuk guxon të qarkullojë me shpejtësi më të madhe se:
(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

508. (kat. B)

Në kushte normale të komunikacionit, shpejtësia e qarkullimit të automjeteve motorike në rrugë publike nuk mund të kufizohet me shenjë komunikacioni nën:
(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

509. (kat. B)

Në autostradë nuk guxojnë të qarkullojnë automjetet motorike të cilat, sipas specifikave të tyre konstruktive, nuk mund të arrijnë shpejtësi më së paku:
(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

510. (kat. B)

Në rrugë publike, shpejtësia e lëvizjes së automjetit motorik që tërheq mjet tjetër në gjendje jo të rregullt, është e kufizuar në:
(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

511. (kat. B)

Në rrugë publike shpejtësia e qarkullimit e veturës që tërheq rimorkio të lehtë, është e kufizuar në:
(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

512. (kat. B)

Në rrugë publike, shpejtësia e qarkullimit e traktorëve është e kufizuar në:
(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

513. (kat. B)

Shofer fillestar është shoferi i automjetit motorik, pas marrjes së patentë shoferit të kategorisë së caktuar në periudhë kohore prej:
(Shëno në vite)

3 pika

514. (kat. B)

Shoferi fillestar që posedon patentë shoferi të kategorisë “B” nuk guxon të drejtojë automjetin, fuqia e motorit e të cilit është më e madhe se:

(Shëno në kw)

3 pika

515. (kat. B)

Personave më të vjetër se 65 vjet, patentë shoferi u jepet me afat të vlefshmërisë më së shumti:

(Shëno në vite)

3 pika

516. (kat. B)

Sanksioni kundërvajtës, ndalesë për drejtim me automjet motorik prej 3 deri më 12 muaj, do t'i shqiptohet shoferit i cili në vendbanim qarkullon me shpejtësi më të madhe nga ajo që është e lejuar, më shumë se:

(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

517. (kat. B)

Sanksioni kundërvajtës, ndalesë për drejtimin me automjet motorik prej tre deri më 12 muaj, do t'i shqiptohet shoferit i cili jashtë vendbanimit qarkullon me shpejtësi më të madhe nga ajo që është e lejuar, më shumë se:

(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

518. (kat. B)

Në rrugë publike në vendbanim shoferi me automjet nuk guxon të qarkullojë me shpejtësi më të madhe se:

(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

519. (kat. B)

Numri i nevojshëm i orëve praktike për aftësim praktik të kandidatit për shofer për kategorinë “B” është:

(Shëno numrin e orëve)

3 pika

520. (kat. B)

Shoferi i cili posedon patentshoferi të kategorisë “B” guxon të tërheq mjet bashkëngjitës, masa e së cilës nuk tejkalon mbi:

(Shëno në kilogramë)

3 pika

521. (kat. B)

Kontrollim i automjeteve motorike, të cilat nuk janë më të vjetra se 8 vite bëhet në:

(Shëno në vite)

3 pika

522. (kat. B)

Lëvizja e lirë e timonit nuk guxon të jetë më e madhe se:
(Shëno në gradë)

3 pika

523. (kat. B)

Distanca ndërmjet automjetit tërheqës dhe atij që tërhiqet, nëse tërhiqet me lidhje të fortë (rudë), është:
(Shënë në metra)

3 pika

524. (kat. B)

Libreza e automjetit jepet me afat vazhdimi prej:
(Shëno në muaj)

3 pika

525. (kat. B)

Drita stop nuk është e domosdoshme të kenë automjetet motorike, të cilat në rrugë të rrafshët nuk mund të qarkullojnë me shpejtësi më të madhe se:
(Shëno shpejtësinë në km/h)

3 pika

526. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Gjatë qarkullimit me automjet, nëse hasni në sipërfaqe me ujë në rrugë, ndërsa në afërsi ka trotuar nëpër të cilin lëvizin këmbësorë, duhet të:

- ☐ të shpejtoni me lëvizjen
- ☐ të vazhdoni të lëviznin me shpejtësi të lejuar
- ☐ ta zvogëloni shpejtësinë dhe t'i largoheni sipërfaqes me ujë

2 pika

527. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Gjatë hasjes në kalimi për këmbësorë me automjet duhet:

- ☐ ta zvogëloni shpejtësinë dhe sipas nevojës të ndaleni
- ☐ ta zmadhoni shpejtësinë e lëvizjes
- ☐ të vazhdoni të lëvizni në përputhje me shpejtësinë e lejuar

2 pika

528. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse gjatë lëvizjes me automjet, në rrugë shikoni ndonjë person i cili e riparon automjetin e vet, e nevojshme është:

- ☐ ta zmadhoni shpejtësinë e lëvizjes
- ☐ të vazhdoni me lëvizjen në harmoni me shpejtësinë e lejuar në rrugë
- ☐ të ndaloni dhe të ofroni ndihmë

2 pika

529. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Gjatë drejtimit me automjet, nëse vëreni se ndonjë shofer me automjetin e vet nuk qarkullon në pajtim me rregullat dhe dispozitat e komunikacionit, është e nevojshme:

- ☐ ta zvogëloni shpejtësinë, me kujdes t'i largoheni dhe sipas nevojës të ndaleni
- ☐ ta ndiqni automjetin dhe ta paralajmëroni me sinjal të zëshëm
- ☐ të bëni bashkëbisedim me shoferin

2 pika

530. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kur udhëtoni me automjet gjatë kohës së natës, nëse nga drejtimi i kundërt vjen automjet me “drita të gjata”, është e nevojshme:

- ☐ t'i lëshoni edhe ju dritat e gjata
- ☐ ta paralajmëroni me sinjal ndriçues (ablindim)
- ☐ t'i ndalni dritat e juaja

2 pika

531. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse qarkulloni në kolonë të automjeteve në komunikacion, është e nevojshme:

- ☐ ta përshtatni shpejtësinë e lëvizjes, sipas intensitetit të komunikacionit
- ☐ të vozitni me shpejtësi në bazë të shenjave të vendosura në komunikacion
- ☐ të zmadhoni shpejtësinë dhe filloni me parakalim

2 pika

532. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Gjatë fillimit me parakalim të automjetit para jush, është e nevojshme:

- ☐ ta paralajmëroni shoferin me sinjal të zëshëm që ta zvogëlojë shpejtësinë
- ☐ me kujdes të filloni me parakalimin, që kur jeni bindur se është e sigurt
- ☐ menjëherë të filloni me parakalim pa marrë parasysh kushtet e rrugës

2 pika

533. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Gjatë drejtimit të automjetit në rrugë, nëse hasni në aksident komunikacioni, në të cilin ka persona të lënduar:

- ☐ me kujdes do ta kaloni vendin e ngjarjes
- ☐ do ta zvogëloni shpejtësinë, pa ndonjë obligim që të ofroni ndihmë
- ☐ do të ndaleni që t'u ofroni ndihmën e parë të lënduarve dhe do ta lajmëroni ndihmën e shpejtë

2 pika

534. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse ndjeni lodhje ose jeni në aso gjendje psikofizike që ndjeheni jo të sigurt për drejtim:

- ☐ mund ta drejtoni automjetin në shoqërim me shofer me përvojë
- ☐ mund ta drejtoni automjetin në relacione të shkurtra
- ☐ nuk mund të filloni me drejtimin e automjetit

2 pika

535. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse me automjet kaloni pranë ndonjë shkolle, çerdhe shkollore apo ndonjë institucioni shëndetësor, duhet:

- ☐ të përdorni sinjal të zëshëm për paralajmërim
- ☐ të lëvizni me shpejtësi të ulët dhe me kujdes të madh
- ☐ ta vazhdoni lëvizjen me shpejtësi të pandryshuar

2 pika

536. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse duke drejtuar me automjetin në rrugë, hasni në kafshë shtëpiake ose kafshë të egër, do të veproni në atë mënyrë që:

- ☐ do ta rrisni shpejtësinë që ta shmangni kafshën
- ☐ do të përdorni sinjal të zëshëm, duke mos e zvogëluar shpejtësinë
- ☐ me kujdes do ta zvogëloni shpejtësinë dhe do t'i lejonit kafshës, që të largohet nga rruga

2 pika

537. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse në komunikacion drejtoni automjet të ri, ai u jep të drejtë:

- ☐ të vozitni më shpejtë nga shpejtësia e lejuar, meqenëse automjeti është i ri
- ☐ të vozitni sipas vlerësimit tuaj të lirë, pa marrë parasysh shenjat e komunikacionit
- ☐ të lëvizni në pajtim me rregullat dhe dispozitat e komunikacionit

2 pika

538. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse drejtoni me automjetin në rrugë dhe hasni në ndonjë person, i cili përpiket që ta largojë automjetin e tij të parregullt nga rruga, do të veproni:

- ☐ me sinjal të zëshëm do t'i bëni me dije se prania e tij e pengon rrjedhën normale të komunikacionit
- ☐ do ta anashkaloni automjetin e tij
- ☐ do të ndaleni që t'i ndihmoni personit për largimin e automjetit

2 pika

539. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse gjatë drejtimit me automjetin tuaj para jush vëreni automjet të auto shkollës të shënuar me shenjë „L“ duhet të veproni në mënyrë që:

- ☐ menjëherë do ta parakaloni automjetin pa dallim të gjendjes në rrugë
- ☐ do të jepni sinjale të shkurtra zëri të vazhdueshme me burinë e automjetit tuaj
- ☐ do të vozitni në përputhje me shpejtësinë e lejuar, do të jeni tolerant dhe të keni mirëkuptim ndaj kandidatit për shofer

2 pika

540. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse para automjetit tuaj vëreni automjet, i cili është i drejtuar nga person i moshuar me shpejtësi të ngadalësuar, do të veproni në mënyrë që:

- ☐ do të jepni sinjale të zëshme dhe ndriçuese drejt automjetit
- ☐ do të jeni tolerant dhe do të lëvizni në përputhje me shpejtësinë e lejuar
- ☐ menjëherë do ta parakaloni automjetin

2 pika

541. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Mungesa e vend parkimit të lirë në ndonjë parking të caktuar, ju jep të drejt që automjetin tuaj:

- ☐ ta parkoni automjetin pas një automjeti tjetër që ndodhet në vendin e vet për parkim
- ☐ fare të mos parkoheni në parkingun
- ☐ të parkoni në hapësirën e gjelbër që ndodhet në afërsi të parkingut

2 pika

542. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Gjatë drejtimit me automjetin tuaj, hasni në zone në të cilën është i ndaluar komunikacioni për automjete motorike, do të veproni në mënyrë që:

- ☐ do të vazhdoni me drejtimin kah zona e ndaluar
- ☐ do të vazhdoni me drejtimin e automjetit vetëm në kahen e lejuar
- ☐ do ta parkoni automjetin para hyrjes në zonën e ndaluar

2 pika

543. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse vëreni se shoku i juaj i cili është nën ndikimin e alkoolit, do të drejtojë me automjetin e tij,do të veproni në mënyrë që:

- ☐ do t'i lejoni të drejtojë me automjetin me përgjegjësi të tij
- ☐ do të jeni shoqërues, që ai më lehtë të drejtojë me automjetin
- ☐ nuk do t'i lejoni të drejtojë me automjetin

2 pika

544. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Obligimi i shoferit për respektimin e situatës së komunikacionit ka të bëjë:

- ☐ për mjedise urbane
- ☐ për mjedise rurale
- ☐ në çdo vend ku është e vendosur dhe e shënuar

2 pika

545. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Përdorimi i treguesve është i obligueshëm:

- ☐ gjatë ndryshimit të drejtimit dhe kahes së lëvizjes
- ☐ vetëm gjatë drejtimit me automjetin në mjediset urbane
- ☐ vetëm gjatë drejtimit me automjetin jashtë vendbanimit

2 pika

546. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse me automjetin tuaj drejtoni në shtet tjetër, Ju lejohe:

- ☐ të vozitni sipas vlerësimit tuaj në përputhje me Kushtetutën e RM-së
- ☐ të vozitni me shpejtësi më të madhe nga e lejuara në përputhje me Ligjin për siguri të komunikacionit në rrugët e RM-së
- ☐ të vozitni në përputhje me sinjalizimin e vendosur të komunikacionit rrugor në atë shtet

2 pika

547. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Gjatë lëvizjes me automjet në rrugë, shoferi dhe personat që barten me të, nuk duhet të lidhen me rrip sigurie, vetëm në raste kur:

- ☐ lëvizë prapa, në parking ose kur lëvizë me shpejtësi të ecjes së njeriut
- ☐ lëvizë nëpër rrugë magjistrale
- ☐ lëvizë nëpër autostradë

2 pika

548. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Me një promil alkool në gjak shoferi mund të drejtojë me automjet motorik:

- ☐ vetëm deri në shtëpi
- ☐ vetëm deri te institucioni më i afërt shëndetësor
- ☐ nuk guxon të drejtojë me automjetin motorik

2 pika

549. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kur në automjetin tuaj bartet fëmijë në moshë mbi 12 vite, përdorimi i rripit të sigurisë për fëmijën është i obliguar:

- ☐ vetëm kur ulet në ulësen e parë
- ☐ vetëm kur ulet në ulësen e prapme
- ☐ kur ulët në ulëse në të cilën ka të instaluar rrip të sigurisë

2 pika

550. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kur gjatë qarkullimit në rrugë me automjetin tuaj hasni në automjete të shënuara me dritë rrotulluese me nxhyrë të kaltër, duhet tu jepni përparësi kalimi:

- ☐ vetëm në vendbanim
- ☐ vetëm kur japin sinjale të zëshme dhe ndriçuese
- ☐ jashtë nga vendbanimi

2 pika

551. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse automjetet pranë jush lëvizin me shpejtësi më të madhe nga e lejuara në atë pjesë të rrugës, do të veproni në mënyrë që:

- ☐ do të vazhdoni të lëvizni në pajtim me shpejtësinë e lejuar
- ☐ do ta përshtatni shpejtësinë e lëvizjes me ato automjete
- ☐ do t'i paralajmëroni me sinjal të zëshëm që ta zvogëlojnë shpejtësinë

2 pika

552. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Ndërgjegjja, si formë më e lartë e jetës psikofizike të njeriut, në komunikacion nënkupton:

- ☐ drejtim të automjetit sipas bindjeve personale
- ☐ drejtim të automjetit me pasqyrim të qartë, real dhe të plotë për situatat e komunikacion
- ☐ drejtim të automjetit me çfarëdo çmim rreziku, derisa shoferi ka nevojë të domosdoshme

2 pika

553. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kujdesi për sigurinë optimale në komunikacionin rrugor paraqet:

- ☐ kujdes i shoferit për automjetin
- ☐ kujdes ndaj të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion
- ☐ kujdes i shoferit për vetveten

2 pika

554. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Roli i familjes në zhvillimin e vetëdijes së komunikacionit te shoferi:

- ☐ ka ndikim të vogël dhe negativ
- ☐ ka ndikim të madh dhe pozitiv
- ☐ nuk ka kurrfarë ndikimi

2 pika

555. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Roli i institucionit edukativo-arsimor në zhvillimin e ndërgjegjes së komunikacion te shoferi:

- ☐ ka ndikim të vogël dhe negativ
- ☐ ka ndikim të madh dhe pozitiv
- ☐ nuk ka kurrfarë ndikimi

2 pika

556. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Integriteti njerëzor dhe vozitës, mund të ruhet me:

- ☐ sjellje kreative në komunikacion
- ☐ sjellje me vet dëshirë në komunikacion
- ☐ sjellje të pandërgjegjshme në komunikacion

2 pika

557. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Vozitje e koncentruar, paraqet:

- ☐ drejtim të vëmendshëm dhe praktik me automjetin
- ☐ drejtim me pavëmendje me utomjetin
- ☐ drejtim të dëmshëm me automjetin

2 pika

558. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Demonstrimi i „forcës“ në komunikacionin rrugor është i lejuar në rast:

- ☐ kur drejtoni me automjetin në komunikacion me dendësi të zmadhuar
- ☐ kur shpejtoni të arrini në ndonjë ngjarje të caktuar
- ☐ nuk është i lejuar demonstrim i „forcës“ në asnjë rast

2 pika

559. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në gjendje të dehur, drejtimi i automjetit, është:

- ☐ më i lehtë
- ☐ më i sigurt
- ☐ jo i sigurt dhe i rrezikshëm

2 pika

560. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Rregulla „kur pi mos vozit, përderisa vozit mos pi “ vlen vetëm për:

- ☐ shoferët-fillestarë
- ☐ të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor
- ☐ pjesëmarrësit më të moshuar në komunikacionin rrugor

2 pika

561. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Morali i komunikacionit si formë e vetëdijes shoqërore, paraqet:

- ☐ dinjitet racional, dhe sjellje të matur në komunikacion
- ☐ drejtim jo etik në komunikacion
- ☐ drejtim sipas vetëdëshirës personale

2 pika

562. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Përdorimi i barërave psiko-aktive ndikon te shoferi në mënyrë që:

- ☐ e zmadhon aftësinë për drejtim me automjetin
- ☐ e zvogëlon aftësinë për drejtim me automjetin
- ☐ nuk ndikon në drejtimin e automjetit

2 pika

563. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Arsimimi në komunikacion fillon të zbatohet:

- ☐ me fillimin e aftësimit për marrjen e patent shoferit
- ☐ pasi të merrni patentë shoferi
- ☐ që nga mosha më e re

2 pika

564. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Komunikimi verbal ndërmjet shoferëve, përderisa drejtojnë automjetin, është:

- ☐ e palejuar
- ☐ e domosdoshme gjatë rreshtimit para udhëkryqit
- ☐ e rëndësishme për marrëveshje të rendit të kalimit para udhëkryqit

2 pika

565. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Roli i personalitetit njerëzor në komunikacionin rrugor bashkëkohor, paraqitet si:

- ☐ faktor i rëndësishëm për sigurinë në komunikacion
- ☐ faktor jo i rëndësishëm për sigurinë në komunikacion
- ☐ nuk ka kurrfarë ndikimi në sigurinë e komunikacionit

2 pika

566. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse gjatë drejtimit me automjet hasni në kalim për këmbësorë, në të cilin kalon person i moshuar dhe i pa aftë, do të veproni në mënyrë që:

- ☐ do të kaloni me automjetin para këmbësorit, pasi që lëviz ngadalë
- ☐ do të pritni që ta kalojë vendkalimin për këmbësorë
- ☐ me sinjal të zëshëm do ta paralajmëroni që më shpejtë ta kalojë kalimin për këmbësorë

2 pika

567. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Konflikti verbal (gojor) ndërmjet shoferëve kur drejtojnë me automjete, është e lejuar në rast kur:

- ☐ njëri vozitës shpejton të arrijë në një vend të caktuar
- ☐ tentojnë ta bindin njëri tjetrin, se cili në mënyrë të drejtë i zbaton rregullat dhe dispozitat e komunikacionit
- ☐ nuk është e lejuar në asnjë rast

2 pika

568. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Të menduarit prej përpara, në praktikën e komunikacionit gjatë drejtimit të automjetit, paraqet:

- ☐ veprim të dëmshëm sepse rrezikohet siguria në komunikacion
- ☐ veprim të dobishëm sepse bëhet vlerësim i drejtë për situata të caktuara që ndikojnë mbi sigurinë e komunikacionit
- ☐ veprim jopraktik, pa ndonjë rëndësi të veçantë për sigurinë në komunikacion

2 pika

569. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Marrëdhëniet humane në komunikacion, duhet t'i zbatoni:

- ☐ çdoherë dhe në çdo vend
- ☐ vetëm nëse vozitni në mjedise urbane
- ☐ vetëm nëse vozitni në mjedise rurale

2 pika

570. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Distanca e rregullt ndërmjet automjeteve si parakusht për siguri në komunikacionin rrugor, vlen vetëm nëse drejtoni:

- ☐ në autostradë
- ☐ në rrugë magjistrale
- ☐ gjithkund, pa dallim të rrugës

2 pika

571. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse duke drejtuar me automjetin në rrugë Ju është dhënë shenjë nga policia e komunikacionit të ndaleni, do të veproni në mënyrën që:

- ☐ me sinjal të zëshëm të sirenës do t'i përshëndetni policët
- ☐ do t'i përshëndetni me ablendim me sinjal ndriçues
- ☐ do ta zvogëloni shpejtësinë e automjetit dhe do të ndaleni

2 pika

572. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse në vendbanim shpejtësia maksimale e lejuar e lëvizjes me automjet është 50 km/h, automjetin tuaj mund ta drejtoni:

- ☐ edhe me shpejtësi më të madhe nëse komunikacioni nuk është intenziv
- ☐ vetëm në pajtushmëri me shpejtësinë e caktuar
- ☐ me shpejtësi deri më 70 km/h, nëse keni ndonjë punë urgjente

2 pika

573. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Policia e komunikacionit kryesisht shërben për:

- ☐ shqiptimin e gjobave të shoferëve
- ☐ kontrollimin dhe rregullim e komunikacionit të rrugëve
- ☐ dhënien e këshillave të drejta shoferëve të automjeteve motorike

2 pika

574. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse gjatë drejtimit me automjet në rrugë dëgjoni muzikë të zëshme, ajo do të Ju mundësojë:

- ☐ koncentrim më të lartë
- ☐ pjesëmarrësit tjerë në komunikacion më lehtë të Ju shohin
- ☐ zvogëlim të përceptimit të ndjenjave dhe eventualisht reaktion jo adekuat

2 pika

575. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në semafor me dritë të kuqe mund të kaloni në rrast kur:

- ☐ nuk ka asnjë automjet tjetër, as këmbësorë në udhëkryqin
- ☐ keni nevojë të shejtë dhe të patjetërsueshme që të arini në ndonjë vend
- ☐ nuk është i lejuar në asnjë rast të kaloni në ngjyrë të kuqe

2 pika

576. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në aksin rrugorë në të cilin gjenden gropa, është e nevojshme që:

- ☐ ta shpejtoni automjetin, me qëllim të kalimit sa më të shpejtë të aksit
- ☐ ta zvogëloni shpejtësinë e lëvizjes sipas kushteve të rrugës
- ☐ të drejtoni me automjetin me manovrim majtas - djathtas

2 pika

577. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Koha e reagimit gjatë frenimit të automjetit për shofer mesatar, në gjendje të mirë psiko- fizike është:

- ☐ 3 – 4 sekonda
- ☐ 1 – 3 sekonda
- ☐ 3/4 e sekondës

2 pika

578. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse jeni në situatë të rrezikshme të keni aksident të drejtpërdrejtë me automjet tjetër, më e sigurtë është që:

- ☐ ta lëshoni timonin dhe t'i mbuloni sytë dhe kokën me duar, me qëllim që të mbroheni nga lëndimet
- ☐ të filloni me frenim dhe kthim të timonit në anën e majtë
- ☐ menjëherë të ktheni në anën e djathtë dhe filloni të frenoni

2 pika

579. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Koeficienti i fërkimit të gomave me rrugën, varet nga:

- ☐ lloji dhe situata e gomave të automjetit
- ☐ lloji dhe tipi i automjetit që e drejtoni në rrugë
- ☐ distanca ndërmjet boshteve të rrotave të automjeteve

2 pika

580. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse aparati i juaj kundër zjarrit nuk funksionon, ndërsa automjetin e ka kapluar zjarri, është e nevojshme:

- ☐ të qëndroni në automjet dhe të pritni të arrijë ndihmë
- ☐ menjëherë të ndërmerri masa tjera përkatëse për shuarjen e zjarrit
- ☐ ta startoni motorin dhe pritni që sistemi për ftohje të shuajë zjarrin

2 pika

581. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kur shoferi para jush drejton automjetin me shpejtësi të vogël:

- ☐ do të jeni të durueshëm dhe në vend të sigurtë ta parakaloni
- ☐ do ta paralajmëroni me sinjal të shkurtër të zërit që të lëviz më shpejtë
- ☐ do të afroheni pas tij dhe me sinjal të gjatë, i njëjti do të përshpejtojë

2 pika

582. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kur me sjelljen personale jo morale, Ju nevrkos ndonjë pjesëmarrës tjetër në komunikacion, Ju:

- ☐ do të kontrolloheni dhe nuk do t'ia ktheni
- ☐ do t'ia ktheni në mënyrë të njëjtë të sjelljes së tij
- ☐ do ta paraqitni në numrin e telefonit 192

2 pika

583. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Njëra nga mënyrat për shmangien e aksidentit, me automjet që lëviz para Jush, është:

- ☐ të vozisni gjithmonë para automjeteve tjera, kurrësi pas tyre
- ☐ ta përshtatni shpejtësinë e lëvizjes së automjetit sipas gjendjes dhe kushteve të rrugës dhe të mbani distancë të sigurt
- ☐ ta drejtoni automjetin në distancë prej 5 metrash, ashtu që do të jeni të përgatitur për frenim të papritur

2 pika

584. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Vozitje defanzive është:

- ☐ zmadhim të vëmendjes dhe drejtim me automjetin me shpejtësi më të madhe nga shpejtësia e kufizuar në rrugë
- ☐ zmadhim të vëmendjes dhe drejtim të automjetit në përputhje me shpejtësinë e kufizuar të rrugës, nivel të lartë të ndjenjave përceptuese të shoferit dhe analizë e kushteve dhe situatës në rrugë, në mënyrë që do t'i parashihet rreziqet potenciale
- ☐ besim në pjesëmarrësit tjerë në komunikacioni

2 pika

585. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kur afroheni prapa automjetit që lëviz ngadalë, duhet që:

- ☐ të afroheni afër automjetit para jush dhe ta detyroni të përshpejtojë
- ☐ me sinjal të zëshëm ose sinjal ndriçues ta paralajmëroni të përshpejtojë
- ☐ të mbani distancë të sigurt dhe në vend të lejuar ta parakaloni

2 pika

586. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Pasi ta ndërroni korsinë tuaj të lëvizjes, veprimi i ardhshëm që duhet ta bëni është:

- ☐ të bëni presion në automjetin që lëviz para jush që t' Ju largohet nga rruga
- ☐ të vozitni shpejtë nëpër ndonjë korsitë tjetër të lirë të rrugës automobilistike
- ☐ të vozitni me kujdes pa i penguar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion

2 pika

587. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Në rast vozitni nëpër rrugë dhe vëreni top se si rrokulliset para automjetit tuaj, Ju duhet:

- ☐ të vazhdoni me vozitje, pasi që e dini se topi nuk është pengesë për automjetin që e drejtoni
- ☐ ta zvogëloni shpejtësinë dhe sipas nevojës të ndaleni, pasi që ekziston mundësia që ndonjë fëmijë do të vrapojë pas topit
- ☐ të shpejtoni dhe të kaloni më shpejtë, sepse ashtu do t'i shmangeni rrezikut që fëmija të mos gjendet para automjetit tuaj

2 pika

588. (kat. B)

Që të jeni të përgatitur për veprim të menjëhershëm me automjetin, duart tuaja duhet të jenë të vëna në timon në pozicion të akrepave të orës:

- ☐ ora 12 e 10 minuta
- ☐ ora 09 e 10 minuta
- ☐ ora 06 e 40 minuta

2 pika

589. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Që ta anashkaloni automjetin i cili është i lënë në anën e djathtë të rrugës, Ju duhet që:

- ☐ të përdorni frenin punues dhe sipas nevojës frenin për parkim për shkak të frenimit të tërësishëm të automjetit të cilin e drejtoni
- ☐ të përdorni frenin punues për shkak të frenimit të tërësishëm dhe ktheheni prapa
- ☐ pasi më parë jeni bindur se korsia e majtë e komunikacionit është e lirë, të njëjtin mund ta anashkaloni

2 pika

590. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse nga ndonjë shkak mund të mos Ju funksionojnë frenat, ju duhet:

- ☐ përnjëherë të ktheni djathtas dhe ta lini që automjeti vet të ndalet
- ☐ të ktheni majtas dhe ta lini që automjeti vet të ndalet
- ☐ ta ndërroni shpejtësinë e lëvizjes në nivel më të vogël të transmisionit, periodikisht ta shtypni frenin punues, të përdorni frenin ndihmës dhe të gjeni vend të përshtatshëm nga ana e djathtë e rrugës ku do të mund të ndaloni në mënyrë të sigurt

2 pika

591. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse gjatë vozitjes ju plas goma e parme e automjetit, Ju duhet:

- ☐ lehtë të shtypni në frenin punues dhe ta ndaloni automjetin
- ☐ të mos përdorni frena, mbani nën kontroll automjetin deri në ndalim në anën e djathtë përkrah rrugës
- ☐ të ktheni në drejtim nga i cili ju tërheq automjeti, të ndaloni dhe kontrolloni se në çfarë gjendje janë gomat tjera.

2 pika

592. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse ju verbon apo ju pengon shkëlqimi i dritave të automjetit që vjen nga drejtimi i kundërt, natën, Ju duhet:

- ☐ ta ktheni shikimin dhe të shikoni në anën e majtë
- ☐ të shikoni te poshtë më së paku tre sekonda
- ☐ të mbani shikimin para nga ana e djathtë.

2 pika

593. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse në rrugë drejtoni me automjetin me shpejtësi të madhe dhe papritmas para jush paraqitet ndonjë kafshë, do të reagoni në mënyrë të drejtë nëse:

- ☐ e zmadhoni shpejtësinë e lëvizjes së automjetit dhe e ktheni timonin majtas ose djathtas me qëllim që t'i shmangeni kafshës, pastaj përdorni sinjal të zëshëm të gjatë
- ☐ e zvogëloni shpejtësinë e lëvizjes së automjetit dhe përdorni sinjal të zëshëm të shkurtër, ndërsa sipas nevojës e ktheni timonin majtas apo djathtas
- ☐ fortë e shtrëngoni timonin e automjetit, nuk e ndryshoni drejtimin e lëvizjes dhe përdorni frenin që të zvogëloni shpejtësinë dhe sipas mundësisë të ndaleni

2 pika

594. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Shkaku që të mos drejtoni me automjetin me shpejtësi mbi të lejuarën, është:

- ☐ gjoba (dënimi) e mundshme e paraparë me Ligj për veprën përkatëse
- ☐ rritja e harxhimit të lëndës djegëse - karburantit
- ☐ zvogëlimi i mundësisë për shkaktimin e fatkeqësisë në komunikacion

2 pika

595. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Për drejtim të sigurt me automjet motorik në rrugë, për shoferin, të rëndësishme janë:

- ☐ njohuritë e fituara dhe shkathtësitë për drejtim me automjetin motorik, si dhe njohja dhe respektimi i rregullave dhe dispozitave të trafikut
- ☐ intuita dhe aftësia që të parashikohet rreziku në rrugë
- ☐ vetit pozitive të karakterit të personit, disponimi momental dhe përgatitja fizike

2 pika

596. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Çfarë është vend i verbër i automjetit, gjegjësisht i ashtu quajtur “kënd i vdekur” ?!

- ☐ hapësirë e cila gjendet deri më 15 metra pas automjetit
- ☐ hapësirë e cila gjendet para automjetit
- ☐ hapësirë e cila gjendet anash automjetit dhe është e pa dukshme për shoferin nga pozita normale e uljes dhe nuk është e dukshme në brendësi, njësoj sikur në pasqyrat e jashtme anësore të automjetit

2 pika

597. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Kur niseni në udhëtim më të gjatë me automjetin tuaj, më së miri është:

- ☐ të jeni të pushuar
- ☐ të merrni sasi më të madhe të kafës dhe çajit
- ☐ të merrni barërra psihoaktive për qetësim i

2 pika

598. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Përgjegjësia e kujt është që të kontrollohet automjeti se a është në gjendje të rregullt dhe a është me pajisje të domosdoshme, para se të niseni në rrugë?

- ☐ e servisit të autorizuar në të cilën servisohet automjeti
- ☐ e shoferi që do ta drejtojë automjetin në rrugë
- ☐ e policëve zyrtarë të uniformuar, që e rregullojnë dhe e kontrollojnë komunikacionin rrugor

2 pika

599. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Nëse ndjeni lodhje gjatë vozitjes së natës me kotje, menjëherë duhet:

- ☐ të shkyçeni nga rruga dhe të pushoni
- ☐ të vazhdoni me vozitje deri te vendbanimi më i afërt
- ☐ të konsumoni pije energjike apo pije tjera stimuluese, të cilat do tu Ju mbajnë të zgjuar

2 pika

600. (kat. A,A1,B,M,F,G)

Gjatë ndrimt të korsisë me automjetin për shkak të qarkullimit më të shpejtë në autostradë, duhet të keni kujdes për rrezikun nga:

- ☐ kalimi i këmbësorëve
- ☐ hasja e veturave nga kahja e kundërt
- ☐ automjet të cilët lëvizin prapa

2 pika

601. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit për rrezik (si në fotografi) i paralajmëron shoferët, se hasin në:

- ☐ kthesë të rrezikshme në të djathtë
- ☐ kthesë të rrezikshme në të majtë
- ☐ rrugë të rrëshqitshme

4 pika

602. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Sipas shenjave të vendosura të komunikacionit në këtë pjesë të rrugës (si në fotografi) shoferët hasin në:

- ☐ rrugë jo të rrafshët për shkak të gungave në rrugë, dhe ndalesës për parakalim të të gjitha automjeteve me veprim (forcë) motorike
- ☐ gropa në rrugë dhe ndalim për anashkalim të automjeteve
- ☐ përpjetëzë e rrezikshme dhe ndalim për parakalim

4 pika

603. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit e treguar në fotografi i paralajmëron pjesëmarrësit në komunikacion se hasin në:

- ☐ rrugë të dedikuar për komunikacion në dyja kahet
- ☐ rrugë me komunikacion një kahësh
- ☐ kryqëzim me rrugë me përparësi kalimi

4 pika

604. (kat. A,A1,B,M,F,G)




Shenja e komunikacionit e treguar në fotografi i paralajmëron pjesëmarrësit në komunikacion se hasin në:

- ☐ përpjetëze të rrezikshme
- ☐ kthesë të rrezikshme në të djathtë
- ☐ teposhtëze (tatpjetëzë) të rrezikshme

4 pika

608. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Sipas shenjave të vendosura të komunikacionit të treguara në fotografi shoferi i automjetit:

- ☐ është i obliguar të ndalet para vijës stop dhe të vazhdojë në kahen e djathtë
- ☐ nuk është i obliguar të ndalet para vijës stop, sepse nuk ka këmbësorë në vendkalim
- ☐ patjetër duhet të ndalet para vijës stop, vetëm nëse në rrugën në të cilën kyçet, qarkullojnë automjete

4 pika

609. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenjat e vendosura nga ana e djathtë e rrugës (si në fotografi) tregojnë:

- ☐ ndalohet ndalja dhe parkimi, si dhe është i ndaluar komunikacioni për këmbësorë
- ☐ ndalohet parkimi dhe shteg për këmbësorë
- ☐ parkim reciprok si dhe rrezik nga këmbësorët në rrugë

4 pika

610. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit (si në fotografi) në këtë pjesë të rrugës tregon:

- ☐ përfundim (ndërprerje) i kufizimit të shpejtësisë së lëvizjes
- ☐ përfundim i të gjitha ndalesave
- ☐ përfundim i ndalesës për parakalim të të gjitha automjeteve me veprim motorik përveç mopedëve

4 pika

611. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Kah shenja e komunikacionit "Emri i vendbanimit" (si në fotografi), është dhënë shenjë për kufizim të shpejtësisë, që vlenë:

- ☐ për tërë lagjën, gjegjësisht vendbanimin
- ☐ deri te udhëkryqi i parë i vendbanimit
- ☐ në gjatësi prej 150 metrash nga vendi i shenjës së vendosur

4 pika

612. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Sipas shenjës së komunikacionit të vendosur në anën e djathtë të rrugës (si në fotografi), kyçeni:

- ☐ në rrugë me komunikacion një kahëshe
- ☐ në rrugë për komunikacion në të dyja kahet
- ☐ në rrugë dytësore

4 pika

613. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Në shenjën e komunikacionit të vendosur "Emri i vendbanimit" (si në fotografinë) i janë shtuar shenjat e komunikacionit për urdhëra të prera, të cilat tregojnë:

- ☐ shpejtësinë më të vogël të lejuar dhe ndërprerjen e të gjitha ndalesave
- ☐ kufizimi i shpejtësisë dhe ndalesë për parkim
- ☐ numri i rrugës dhe ndalesë për ndalje dhe parkim

4 pika

614. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Sipas shenjës së komunikacionit të vendosur (si në fotografi) vetura lëviz:

- ☐ në rrugë me përparësi kalimi
- ☐ në rrugë dytësore
- ☐ në rrugë me rëndësi të njëjtë me rrugën që kryçëzohet

4 pika

615. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit e vendosur në anën e djathtë të rrugës mbi shenjën për lajmërim, paraqet ndalesë komunikacioni për automjetet:

- ☐ gjerësia e përgjithshme e të cilave tejkalon tre metra
- ☐ gjatësia e së cilës kalon mbi tre metra
- ☐ lartësia e përgjithshme e së cilës kalon mbi tre metra

4 pika

616. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Sipas shenjave të komunakacionit të vendosura (si në fotografi) shoferi i automjetit:

- ☐ është i obliguar që të qarkullojë me shpejtësi deri më 40 km/h dhe nuk guxon të kalojë pa u ndalur, për shkak të pagesës rrugore
- ☐ është i obligur që të qarkullojë me shpejtësi më të madhe se 40 km/h, pa obligim që të ndalet në pagesën rrugore
- ☐ është i obliguar që të qarkullojë me shpejtësinë e rekomanduar të shenjës, kah kontrolli doganor

4 pika

617. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Sipas shenjave të komunikacionit të vendosura (si në fotografi) shoferi i automjetit has në një pjesë të autostradës, në të cilën:

- ☐ ekziston rrezik nga rrugë e rrëshqitshme dhe ndalesë për anashkalim të automjeteve ngarkuese
- ☐ ekziston rrezik nga përmbysja e automjeteve dhe ndalesë komunikacioni për automjetet ngarkuese
- ☐ ekziston rrezik nga kolona e automjeteve të ndalura dhe ndalohet parakalimi i automjeteve ngarkuese

4 pika

618. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Ndalesën që e japin shenjat e komunikacionit (të treguara në fotografi) fillon nga vendi i vendosjes së shenjave dhe vlejnjë:

- ☐ deri te udhëkryqi i parë
- ☐ në gjatësi deri më 150 metra pas shenjave të komunikacionit të vendosura
- ☐ në gjatësi deri 250 metra pas shenjave të komunikacionit të vendosura

4 pika

619. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Në këtë pjesë të rrugës, ndalimi për parakalim të të gjitha automjeteve me veprim (fuqi) motorike, për shoferët fillon të zbatohet:

- ☐ pas 150 metrave të kaluara të rrugës prapa shenjës së vendosur të komunikacionit
- ☐ nga vendi ku është e vendosur shenja e komunikacionit
- ☐ pas 250 metrave të kaluara nga rruga pas shenjës së vendosur të komunikacionit

4 pika

620. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Vetura e paraqitur në fotografi në këtë pjesë të rrugës qarkullon:

- ☐ sipas rregullave, pasi që nuk ka automjet nga kahja e kundërt
- ☐ jo sipas rregullave meqenëse qarkullon në kahe të kundërt
- ☐ sipas rregullave, për shkak të pamjes (qartësisë) gjatë drejtimit me automjetin

4 pika

621. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit e treguar në fotografi, bën pjesë në grupin e shenjave:

- ☐ të urdhrave të prera
- ☐ të lajmërimit
- ☐ të rrezikut

4 pika

622. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Vetura e paraqitur në fotografi:

- ☐ guxon të kthejë majtas në udhëkryq
- ☐ nuk guxon të kthejë djathtas në udhëkryq
- ☐ nuk guxon të kthejë majtas në udhëkryq

4 pika

623. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit e treguar në fotografi, jashtë vendbanimit vendoset në largësi:

- ☐ prej 150 deri më 250 metra para vendit të rrezikshëm në rrugë
- ☐ prej 100 metra para vendit me rrezik
- ☐ prej 40 deri më 80 metra para vendit me rrezik

4 pika

624. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit e treguar në fotografi, bën pjesë në grupin e shenjave:

- ☐ për obligim
- ☐ për lajmërim
- ☐ për rrezik

4 pika

625. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit për “urdhra të prera” të paraqitur (si në fotografi) ua bën me dije pjesëmarrësve në komunikacion për:

- ☐ shpejtësinë më të vogël të lejuar me të cilën duhet të lëvizin
- ☐ kufizim të shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve
- ☐ shpejtësinë që rekomandohet në këtë pjesë të rrugës

4 pika

626. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit e paraqitur në fotografi me tri vija të pjerrëta të kuqe, vendoset:

- ☐ në 240 metra para kalimit të rrugës përtej hekurudhës
- ☐ në 500 metra para kalimit të rrugës përtej hekurudhës
- ☐ në 100 metra para kalimit të rrugës përtej hekurudhës së tramvajit

4 pika

627. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes të automjeteve në këtë pjesë të rrugës në vendbanim, është:

- ☐ 50 km/h
- ☐ 55 km/h
- ☐ 60 km/h

4 pika

628. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit e vendosur në anën e djathtë të rrugës paraqet shenjë:

- ☐ për nyje të autostradave
- ☐ për mbyllje të korsisë së komunikacionit
- ☐ për aks rrugor të rrugës magjistrale

4 pika

629. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Sipas situatës në fotografi dhe shenjave të komunikacionit të vendosura, hasni në një pjesë të rrugës me shpejtësi të kufizuar të lëvizjes, ku:

- ☐ kryhen punime në rrugë dhe guxoni të vazhdoni vetëm në kahet e lejuara
- ☐ ekziston rrezik nga këmbësorët në rrugë dhe obligim për qarkullim në kahun e obliguar në të djathtë
- ☐ hyni në rrugë me komunikacion një kahësh dhe ndalesë për realizim të punëve në rrugë

4 pika

630. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit e parqitur në fotografi në këtë pjesë të rrugës, tregon:

- ☐ fëmijë në rrugë
- ☐ shkollë në afërsi
- ☐ zonë me komunikacion të qetë

4 pika

631. (kat. A,A1,B,M,F,G)



Shenja e komunikacionit e paraqitur në fotografi tregon, ndalesë për qarkullim të automjeteve:

- ☐ lartësia e përgjithshme e të cilave e tejkalon lartësinë e përcaktuar
- ☐ pesha e përgjithshme e të cilave e tejkalon peshën e caktuar
